

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA



QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera  
- Ministry of Finance, Labour and Transfers



INSPEKTORATI  
QENDROR I PUNËS

Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate

## INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS

02V- 106/25/1427

INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS  
Centralna Inspektorat Rada  
Central Labour Inspectorate

106/25 03  
16.01.26  
MITROVICA / MITROVICA, MITROVICA

Inspektorët e Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve - të Inspektoratit Qendror të Punës, Divizioni në Rajonin e Mitrovicës, Inspektori [REDAKTUAR] të autorizuar me dispozitat e Nenit 83, 92 dhe 94 të Ligjit nr.03/L- 212 të Punës, dispozitës të nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe Ligjit Nr.03/L-017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, procesverbal të inspektimit me nr. 02-106/25/1427 të datës 09.12.2025, procesverbal të riinspektimit me nr. 02-106/25/1427A të datës 08.01.2026, më datën 16.01.2026, merr këtë:

## V E N D I M

### Për shqiptimin e masës ndëshkimore

Subjekti juridik "Hotel Palace & Spa Center" Sh.p.k. me NUI 811327635; adresa: fshati Shupkofc, Komuna e Mitrovicës, me pronar [REDAKTUAR] (në tekstin në vijim punëdhënësi) konstatuam këtë gjendje faktike:

- Cenimin e dispozites së nenit 7 paragrafi 4, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.22 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro**
- Cenimin e dispozites së nenit 10, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro.**
- Cenimin e dispozites së nenit 55, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.25 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro.**

- *Cenimin e dispozitës së nenit 72, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 3 nënparagrafi 3.16 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro.***
- **Gjithsej ndaj Subjektit juridik “Hotel Palace & Spa Center” Sh.p.k. me NUI 811327635: adresa: fshati Shupkofc, Komuna e Mitrovicës, me pronar [REDAKTUAR] i shqiptohet Gjoba në lartësi prej Tetëqind (800.00) Euro.**

Dëftesa mbi pagesën e gjobës merrët në Inspektorat të Punës, adresa: Rr:“Afrim Zhitia” p.n. Mitrovicë, afati i pagesës 30 ditë.

Punëdhënësi duhet të dëshmoj pagesën e gjobës, duke dorëzuar një kopje të pagesës në zyrën e Inspektoratit të Punës, në Mitrovicë, rruga:“Afrim Zhitija”, (Ndërtesa e ish Administratës Pensionale), kati i III-të, zyrja nr.06, në të kundërtën do të konsiderohet se nuk është bërë pagesa dhe do iniciohet procedura përmbareuese tek organet kompetente.

## **A r s y e t i m**

Me rastin e inspektimit në subjektin e lartëcekur sipas ankesës nga [REDAKTUAR] me nr. prot 247/25 të datës 24.11.2025, lidhur me pretendimet se ka punuar pa kontrate, pa lajmeruar ne ATK, mospagesë e pagës për 20 ditë, së bashku me kolegun [REDAKTUAR] kemi dalur në inspektim, me datë 09.12.2025.

Gjatë inspektimit kemi obliguar punëdhënësin që të prezentoj këtë dokumentacion:

- Kontratat e punëtorëve;
- Listën e punëtorëve;
- Listën e pagave;
- Ekzekutimin e pagesave te pages;
- Vendimin për ndërprejten e mardhënies së punës.

Edhe pas afatit të dhënë prej 03 ditëve, punëdhënësi nuk ka prezentuar dokumentacionin e kërkuar me procesverbal.

**Nga lëmia e marrëdhënies së punës:**

- **Punëdhënësi** nuk ka prezantuar dëshmitë se punëtori që ka bërë ankesë është i lajmëruar në (ATK), konform dispozitën së nenit 7 paragrafi 4 i Ligjit nr.03/L-212 i Punës. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 7, par. 4, i Ligjit nr.03/L-212 i Punës.
- **Punëdhënësi** nuk ka prezantuar kontratën e punës për punëtorin që ka bërë ankesë, konform dispozitës së nenit 10, të Ligjit 03/L-212 i Punës. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 10, i Ligjit nr.03/L-212 i Punës.
- **Punëdhënësi** nuk ka prezentuar dëshmi lidhur me ekzekutimin e pagesës së pagës, konform me dispozitën e nenit 55 i Ligjit nr.03/L-212 i Punës. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 55, i Ligjit nr.03/L-212 i Punës.
- **Punëdhënësi** nuk ka prezentuar vendimin për ndërprerje të mardhënies së punës, konform nenit 72, par 1, të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, ku (citojmë): “1. *Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje*”. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 72 par. 1, i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.

Andaj duke u bazuar nga të dhënat e cekura më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Punëdhënësi është i obliguar, që në vazhdimësi të bëjë zbatimin e dispozitave të Ligjeve në fuqi, Ligji 03/L-212 të Punës dhe Ligjit 04/L- 161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, në të kundërtën moszbatimi i dispozitave të këtyre ligjeve do të merren si masë rëndësuese dhe do të cilësoheni si recidivist.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet subjektit juridik “Hotel Palace & Spa Center” Sh.p.k. dhe kopjet tjera mbesin në Inspektoratin e Punës për procedura të mëtutjeshme.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin e Ankesave të MFPT-së, nëpërmes Inspektoratit të Punës në Mitrovicë, Rruga: “Afrim Zhitia”, ish objekti i ndërtesës pensionale, kati i dytë, nr.34, Mitrovicë.

Data: 16.01.2026

Ora: 13:00.

  


23.01.2026

Inspektorët e Punës

